



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



22-28 DHJETOR

JAVA E MBROJTJES



SHQIPËRIA PAJISËT ME SISTEMIN RAKETOR “JAVELIN”

Shqipëria është pajisur zyrtarisht me sistemin raketor kundërtank “Javelin”, një nga sistemet më të avancuara të mbrojtjes që përdoret nga vendet anëtare të NATO-s. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu bëri të ditur se ardhja e këtij sistemi është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me aleatin strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

JM



MINISTRI VENUGU TAKIM ME HOMOLOGUN BULLGAR

Shqipëria dhe Bullgaria konfirmuan qëndrime të përbashkëta mbi sigurinë në Evropën Juglindore dhe rendësinë e modernizimit të kapaciteteve mbrojtëse. Në takimin mes ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu dhe homologut të tij bullgar Atanas Zapryanov u vlerësua kontributi shqiptar në NATO dhe u diskutua forcimi i bashkëpunimit ushtarak.

JM



MINISTRI VENUGU NË BAZËN E NATO-S

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë në Bazën e Grup-Batalionit Shumëkombësh të NATO-s në Novo Selo, Bullgari, ku shërbejnë edhe efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Gjatë vizitës, ministri u njoh me angazhimin dhe kontributin e togës shqiptare, e cila luan një rol aktiv në përmbushjen e detyrave të grupit, duke kontribuar përtej misionit të saj të paracaktuar.

★★★★★

STËRVITJE E PËRBASHKËT SHBA-SHQIPËRI

Forcat Speciale të SHBA zhvilluan një stërvitje të përbashkët me Forcat Speciale shqiptare në Zall-Herr, në kuadër të gatishmërisë për dislokim emergjent. Stërvitja synon rritjen e ndërveprueshmërisë dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve.

JM

★★★★★



QENDËR RAJONALE NË BURREL

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu zhvilloi një takim me efektivët e Batalionit III të Regjimentit të Këmbësorisë në Burrel ku vlerësoi profesionalizmin dhe rolin e tyre në sigurinë e zonës. Gjatë vizitës u bëri të ditur se në vitin 2026 në Mollëz të Burrelit do të nisë ndërtimi i një qendre të re operacionale, e cila do të shërbejë për trajnimin e forcave dhe mbështetjen e emergjencave civile në rajon.

★★★★★



Vendi

FITUES
ÇMIMI I TRETË

Maratona Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2025
£ 300

Tiranë, 19 Dhjetor 2025

Partner: Raiffeisen Bank



AKADEMIA E AFA TRIUMFON NË MARATONËN KIBERNETIKE

Ekipi i Akademisë së Forcave të Armatosura u shpall fitues i Maratonës Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, të organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike. Arsimi dhe inovacioni janë dy nga prioritetet tona absolute, të cilat ndërthuren natyrshëm në fushën e mbrojtjes kibernetike. Ky sukses tregon se puna për forcimin e këtyre kapaciteteve po jep frytet e veta.

★★★★★

mod.gov.al

JM

XHENIOT NDËRTOJNË URËN E DYTË NË PAPËR-SOLLAK

Batalioni i Xhenios në Komandën Mbështetëse përfundoi ndërtimin e urës së dytë metalike tip “Bailey” në lagjen Matrej, fshati Papër-Sollak, bashkia Elbasan, duke përforcuar infrastrukturën lokale dhe qarkullimin në zonë.

JM

